

Nr.regj. 04-478/11

GJYKATA KOMUNALE E KUNDERVAJTJES NE GJAKOVE, me Gjyqtaren Manduhije Syla, duke vendosur ne procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Osman Gojani nga Gjakova, për shkak të kundërvajtjes nga neni 6,7.16.1 e 1.2 të Ligjit per deklarimin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuraave të zyrtareve të lartë Publik Nr.03/L-151 të Kosovës duke u mbështetur ne nenin 73,74,110,195,198 al.1 pika 7 dhe neni 27 al. 4 te Ligjit mbi kundërvajtjet me dt. 19.09.2013 mure këtë

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse e inicuar kundër të pandehurit Osman Nazmi Gojani nga Gjakova Rr."I.Qemajli" nr. 72 ,ku edhe tani banon , 6,7.16.1 e 1.2 të Ligjit per deklarimin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë Publik Nr.03/L-151 të Kosovës, se është shkaktuar parashkrimi për se zhvillimin e procedurës kundërvajtjes.

-Konform nenit 198 al.1 pika 7 te LMK .

Arsyetim

Sipas kërkesës të Agjencisë kundër korrupsionit në Prishtinë nr. 01-322/11 të dt. 12.07.2011 është filluar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit, për shkak te veprës kundërvajtëse nga neni 6,7.16.1 e 1.2 të Ligjit per deklarimin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuraave të zyrtarëve të lartë Publik Nr.03/L-151 të Kosovës

Gjykata me rastin e shiqimit te shkresave te lëndës ,konstatoi se edhe pas ndërmarrjes së veprimeve nga kjo Gjykate, shihet se ka radhë deri te parashkrimi absolut i ndjekjes me dt.12.07.2013,per shkak se vepra kundërvajtëse është kryer me dt.12.07.2011,në këtë rast kanë kaluar dy vite nga data kur është kryer kundërvajtja , pasi që lënda ka qenë te ish Kryetarja për kundërvajtje dhe për këtë arsye ka ardhë gjër te parashkrimi absolut, konformenenit 27 al.4 te LMK.


Duke u bazuar ne parashtrimet e me sipërme, Gjykata konform nenit 198 al.1 pika 7 te Ligjit mbi kundërvajtjet , PEZULLOI procedurën lidhur me këtë çështje.

Aktivendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Dep.i Përgjithshëm-Diviz.i Kundërvajtjes

Nr.regj.04-478/11 te dt.19.09.2013



UDHËZIME JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë ne afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktevendimi dhe këtë Gjykatës së Apelit-Dep.i Përgjithshem Diviz.Kundërvajtjes në Prishtinë , përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA KUNDËR KORUPSIONIT AND CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/DMP	Nr. Prot. 03-3074/13
Dep. DPK/DMP	Prot. No. 03-3074/13
Nr.faq. 01	Data 27-09-2013
Broj. stranca	Data
Kopjes	Data
PRISHTINE	